



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200192/3

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, si dhe rregullimet ligjore në strukturën organike të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë .*

Drejtuar: **Z. Ulsi MANJA**
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Znj. Ogerta MANASTIRLIU
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Z. Admir ABRIJA
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Për dijëni: **Z. Edi RAMA**
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të shtetasve, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), zhvilloi një vizitë inspektuese në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë, pak muaj pas transferimit nga IEVP "Zahari", Krujë, të personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale ose për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën mjekësore "mjekim i detyruar" apo "shtrim i përkohshëm" në një institucion mjekësor.

Vizita inspektuese u zhvillua në datë 17.02.2022 dhe kishte si tematikë vlerësimin e kushteve në IEVP Lezhë për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e

ambienteve rekreative për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre.

Një aspekt tjetër i vizitës inspektuese, kishte të bënte me monitorimin e situatës së trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor të transferuar në këtë institucion, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore” ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) të nënshkruar më datë 23.11.2021, si dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për këtë qëllim.

Në vijim, po Ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur disa nga gjetjet më të rëndësishme të kësaj vizite monitoruese, që kanë të bëjnë me misionin tonë kushtetues dhe ligjor.

Në vite, Avokati i Popullit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbikëqyrjes të situatës së respektimit të të drejtave dhe lirive të personave që vuajnë nga sëmundje dhe çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të cilët kanë qëndruar në IEVP “Zahari”, IVSHB (Spitali i Burgjeve), Tiranë, apo dhe në sektorët e kujdesit të veçantë pranë institucioneve të ekzekutimit të dënimeve penale, ashtu si edhe në spitale/pavione psikiatrike me shtretër.

Vlen të theksojmë që në krye të herës se, në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara dhe të ratifikuara nga legjislativi shqiptar, përcaktohet qartë se, shtetasit për të cilët është dhënë masa mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtirim i përkohshëm”, **nuk** duhet të jenë të akomoduar në IEVP në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por ata duhet të trajtohen në një Institucion të Posaçëm Mjekësor në varësi të MSHMS.

Ligji nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, ka përcaktuar qartë se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtirim i detyruar”, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar, dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

Konkretisht, në nenin 28, pika 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Ky përcaktim ligjor, tregon qartë prioritetin që ligji i kanë dhënë mbrojtjes së shëndetit të këtyre personave, pavarësisht natyrës së veprës penale që ata kanë kryer, si dhe ka përcaktuar qartësisht institucionin mjekësor të posaçëm dhe varësinë institucionale, ku duhet të kryhet trajtimi mjekësor i tyre.

Edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Europës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, në raportin me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare, ka theksuar se: *“Administrimi i spitalit të ri në burgun e Lezhës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mundësojë shërbime të specializuara për këtë kategori, duke bërë të mundur aksesin e këtyre pacientëve në aktivitete kuptimplota jashtë qelive, përkujdesjen e nevojshme njerëzore dhe kontaktin me specialistë (psikiatër, psikologë, kujdestarë)”*.¹

Me qëllim monitorimin proaktiv të respektimit të të drejtave të të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor të akomoduar në sistemin penitenciar, Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet MKPT-së në periudhën 2014 – 2021 ka kryer gjithsej 35 inspektime në spitalet psikiatrike si dhe në IEVP “Zahari”, Krujë, ku në përfundim të tyre ka adresuar edhe rekomandimet përkatëse në përputhje me gjetjet e tij, kryesisht lidhur me problematikat në fushën e shëndetit mendor.

Ndërkohë, Avokati i Popullit në raportet periodike drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen për gjendjen në të cilën ndodhen spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri dhe në veçanti në IEVP Zahari. Theksi në këto raporte dhe rekomandime, krahas evidentimit të gjetjeve dhe problematikave në këtë fushë, është vënë në domosdoshmërinë e ngritjes sa më parë të një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, i cili do të përmirësonte cilësinë e shërbimit shëndetësor për trajtimin e personave me masë mjekësore.

Pavarësisht presionit të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendase, si dhe disa përpjekjeve nga ana e qeverive ndër vite, për të ndërtuar një institucion të veçantë për personat me masë mjekësore me vendim gjykate, ende edhe sot nuk është arritur asnjë rezultat konkret, përfshirë këtu edhe mos miratimin e VKM-së në zbatim të nenit 28/2 të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”.

Në momentin e kryerjes së vizitës inspektuese në IEVP Lezhë në datë 17 shkurt 2022, Avokati i Popullit konstatoi se, në seksionin e personave me masë mjekësore **ishin akomoduar në total 349 persona**, nga të cilët 225 shtetas me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, 119 shtetas me masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”, si dhe 5 shtetas paraplegjik të dënuar me vendim gjykate.

Ndërkohë, sipas projektit të ndërtimit për përshtatjen në spital të ambienteve në dy godinat e IEVP Lezhë, pajisja me shtretër ishte për mbajtjen dhe trajtimin e **184 (maksimumi 200) shtetasve** me masë “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”, përveç ambienteve të destinuara si sallë për urgjencat, laboratorët, klinikat mjekësore të mjekëve, dhomat e infermierëve, për personelin mbështetës (sanitar dhe kujdestarë), si dhe ambienteve për punën e administratës.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë kohës të funksionimit të IEVP “Zahari”, Krujë, por edhe aktualisht në IEVP Lezhë, midis të tjerave, ka evidentuar

¹ CPT Report 2019, faqet 7,37,38, si dhe faqja 45, <https://rm.coe.int/16809cb571>

dhe një problematikë që lidhet me vendimet e gjykatave kompetente për dhënien e masës mjekësore për personat me çrregullime të shëndetit mendor, si dhe me ekzekutimin e vendimeve penale me masë mjekësore, duke i akomoduar këtë kategori në ambientet e këtyre IEVP-ve dhe jo në një institucion të posaçëm mjekësor, brenda sistemit shëndetësor të integruar.

Akomodimi i këtyre personave me masë mjekësore në IEVP, ka sjell rrjedhimisht mbipopullim të seksioneve, duke humbur qëllimin për të cilin ato janë krijuar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Trajtimi dhe akomodimi jo adekuat i personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” të vendosur nga gjykata, mbi kapacitetin fizik në IEVP Krujë, por edhe në IVSHB (Spitali i Burgjeve), është denoncuar vazhdimisht nga institucioni i Avokati i Popullit, si një shkelje flagrante e ligjit dhe e standardeve ndërkombëtare, që sjell trajtim diskriminues dhe denigrues të këtyre pacientëve si dhe përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore.

Personat me çrregullime të shëndetit mendor e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisiplinar, në çdo kohë, pavarësisht nga regjimi i mbajtjes së tyre.² Megjithatë, ashtu sikurse është përmendur në rekomandimet në vite të institucionit të Avokatit të Popullit, situata e mbipopullimit, mungesat në stafin mjekësor të specializuar si dhe në radhët e ekipit multidisiplinar (i cili ose ka probleme me kualifikimin ose është në numër të ulët), e bënin të pamundur respektimin e këtij standardi të vendosur edhe nga institucionet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Kjo problematikë, është evidentuar edhe në raportin me rekomandime të KPT-së, në vizitën inspektuese në Shqipëri në vitin 2018. Midis të tjerave në këtë raport thuhet se: “*KPT ndër vite ka ngritur shqetësimin se situata e pacientëve me masë "mjekim i detyruar" në Shqipëri ka qenë subjekt i një dialogu të gjatë midis KPT-së dhe autoriteteve shqiptare. Në raportin për vizitën e tij të fundit, KPT shprehu shqetësim serioz megjithë rekomandimin specifik të bërë në mënyrë të përsëritur nga Komiteti që nga vizita e vitit 2000 dhe në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, pacientët me masë "mjekim i detyruar" vazhdojnë të mbahen në Spitalin e Burgut në Tiranë dhe në Institucionin e Veçantë të Zaharisë në Krujë në kushte të papranueshme*³. Në fakt, kushtet e jetesës në këto dy institucione ishin përkeqësuar më tej që nga vizita e vitit 2014 (në veçanti për sa i përket gjendjes së riparimit dhe mbipopullimit)⁴, dhe niveli i kujdesit psikiatrik mbetet qartë i pamjaftueshëm. Në përgjithësi, Komiteti krijoi përshtypjen e “braktisjes terapeutike” të shumë pacientëve. KPT ka kërkuar:

² CPT/Inf (92) 3 – part 2, parag. 56.

³ shih: <https://rm.coe.int/16808ae48f> “Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 2 to 9 February 2017 CPT/Inf (2018), fq. 45.

⁴ Më datë 2.12.2020 rezultoi se kapaciteti i këtij institucioni është 196 persona, ndërkohë që aktualisht ndodhen 292 persona. Mbiipopullim 96 persona.

- *informacion të detajuar mbi hapjen e objektit psikiatrik në burgun e Lezhës (përfshirë mënyrën e menaxhimit të kësaj strukture, numrin e stafit të përkujdesjes shëndetësore dhe të stafit tjetër të specializuar, trajnime të stafit, mënyrën e sigurisë, mundësimin e aktiviteteve terapeutike dhe rekreative etj).*
- *konfirmimin se të gjithë pacientët janë transferuar në Lezhë.*
- *një kopje të konceptit të rishikuar për ndërtimin e institucionit psikiatrik në Tiranë”.*

Sa më sipër, rezulton që KPT gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, ashtu si edhe në vizitën e mëparshme të zhvilluara në datën 4-14 shkurt 2014, ka konstatuar se, niveli i kujdesit shëndetësor për personat me masë mjekësore ka qenë në kushtet e braktisjes terepautike të këtyre pacientëve.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, shtetasve me masë mjekësore ju janë cënuar rëndë të drejtat e tyre, kjo pasi prania e tyre në burgje është e kundraligjshme. Kësaj i shtohet edhe faktit që në vite nuk ka patur një përmirësim të qenësishëm në rritjen e numrit të stafit mjekësor, si dhe situata e braktisjes terepautike e konstatuar nga KPT, ende nuk ka ndryshuar. Kjo problematikë ka patur ndikim edhe në mbipopullimin e I EVP Zahari dhe aktualisht të I EVP Lezhë, duke përkeqësuar klimën në këto institucione.

Në përgjigje të rekomandimeve dhe komunkimeve që ka patur Avokati i Popullit, në kuadër të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të KPT-së, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë bërë me dije se, prej kohësh këto institucione kishin planifikuar të nënshkruhej një marrëveshje bashkëpunimi mes MSHMS dhe MD, për ngritjen dhe funksionimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm, ku do të parashikohen detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit institucion përgjatë këtij procesi ⁵ në kuadër të një zgjidhjeje, që do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e kushteve dhe trajtimit të këtyre personave. *Por, kjo marrëveshje nuk ishte hartuar apo dakortësuar ndër vite, megjithë premtimet e bëra nga MD në kthim përgjigjet drejtuar Avokatit të Popullit ndaj raportit të KPT-së, deri në finalizimin e saj në nëntorin e vitit 2021.*

Pavarësisht kohës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, vlen të përmendim faktin se, në nëntor të vitit 2018 me fondet e buxhetit të shtetit,⁶ filluan punimet për rikonstruksionin dhe përshtatjen sipas parametrave teknik dhe mjekësor të një spitali forensik, në dy prej godinat që ndodheshin brenda territorit të I EVP Lezhë.⁷

Në raportin me rekomandime të KPT-së (botuar në vitin 2019), Qeveria Shqiptare ka marrë angazhimin⁸, për ndërtimin, përshtatjen e godinave për personat me masë mjekësore në

⁵ <https://kmd.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendim-nr.-255-date-19.12.2018-A.B-kunder-MSHMS.pdf>
faqja 6

⁶ <https://drejtesia.gov.al/institucion-i-posacem-per-te-denuarit-me-masa-mjekesore/>

⁷ <https://kmd.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendim-nr.-255-date-19.12.2018-A.B-kunder-MSHMS.pdf>
faqja 7

⁸ <https://rm.coe.int/16809cb571/> Raporti me rekomandime i CPT 2019 dhe përgjigjet e Qeverisë Shqiptare. <https://www.drejtesia.gov.al/newsroom/lajme/rikonstruktohet-spitali-i-burgjeve-kushte-dinjitoze-per-sherbimin-shendetesor-per-te-denuarit/>

IEVP Lezhë, si dhe kalimin e administrimit të personelit shëndetësor nën juridiksionin e MSHMS, deri në fundin e vitit 2019. Brenda këtij afati kohor, përfshihej edhe transferimi i personave me masë mjekësore nga I EVP “Zahari, Krujë, për në godinat e reja të ndërtuara në I EVP Lezhë.

Në zbatim të këtyre masave, me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.8927/1, datë 27.09.2018 “Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, I EVP “Zahari”, Krujë, kaloi në konservim (*mbyllje e përkohshme*), me qëllim për të mos pranuar shtrimin e personave me masë mjekësore tej kapaciteteve akomoduese, si një masë paraprake deri në transferimin e tyre në I EVP Lezhë, por dhe kjo masë nuk u zbatua nga organet e zbatimit të ligjit dhe ato të ekzekutimit të vendimeve penale. Institucioni vijoi të ishte funksional dhe mbipopullimi pësoj përkeqësim të dukshëm, gjatë viteve 2018-2021. Konkretisht, viti 2018 kishte 100 persona, viti 2019/100 persona, viti 2020/103 persona dhe viti 2021/118 persona, mbi normën e akomodimit për 190 persona me masë mjekësore, që kishte I EVP Zahari.

Në kuadër të misionit të monitorimit për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së, Avokati i Popullit, komisioneri i MKPT-së dhe një grup pune i MKPT-së, inspektuan në muajin qershor dhe dhjetor të vitit 2019, ecurinë e punimeve për ndërtimin e godinave të reja në I EVP Lezhë, ku u evidentua (sipas informacionit të drejtuesve të I EVP Lezhë), se punimet ishin ndërprerë nga subjekti kontraktues, për shkak të mos realizimit të punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes dhe mosalokimit të fondeve nga Ministria e Drejtësisë, për këtë qëllim.

Periudha e pandemisë (viti 2020-2021), për shkak të emergjencës shëndetësore nga COVID-19, ishte një faktor tjetër që ndikoi në ngadalësimin e zbatimit të procesit të transferimit të personave me masë mjekësore, pasi me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, një nga godinat e rikonstruara u kthye në spital për shtrimin e të burgosurve në sistemin e burgjeve, të infektuar me COVID-19.

Avokati i Popullit i gjen të pajustificuara vonesat në lidhje me dhënien fund të këtij trajtimi për personat që prej vitesh u ndodhën në I EVP Zahari, Krujë. Në vlerësimin tonë, kishte mundësi të merreshin masa për të mënjeluar kushtet e neglizhencës terapeutike në të cilën ndodheshin personat në fjalë. Situata e tyre është çënuar ndjeshëm nga mungesa e vizitave të familjarëve, për më shumë se 16 muaj (Mars 2020-Korrik 2021).

Me insistimin e Ministrit të Drejtësisë z.Manja, që në fillim të mandatit të tij ministror, investimi për rikonstruksionin e godinave në I EVP Lezhë dhe kompletimi me pajisje mjekësore dhe hotelerie, përfundoi në muajin Tetor të vitit 2021.

Referuar rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare si Komitetit kundër Torturës të Këshillit të Evropës (KPT) organizatave jofitimprurëse që operojnë në vend (Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH, Shoqata Përthyerje, etj.), paraprakisht u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në datë 23.11.2021 “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”.

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr.8927/1, datë 27.09.2018 “Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve miratoi Planin e Masave me nr.1240 prot., datë 18.11.2021 “Për transferimin e shtetasve me masë mjekësore nga I EVP Krujë në I EVP Lezhë”, duke i krijuar mundësinë strukturave përgjegjëse të sigurisë dhe atyre të shëndetësisë në përbërje të DPB-së, I EVP “Zahari”, Krujë dhe I EVP Lezhë, **të kryejnë transferimin e personave me masë mjekësore, për në ambientet e krijuara në godinat e reja, në datat 27 – 29 Nëntor 2021.** Përmbyllja e këtij procesi është përshëndetur nga Avokati i Popullit.

Në lidhje me situatën dhe problematikat në të cilën ndodheshin personat e akomoduar në I EVP Zahari, AP ka dërguar në muajin nëntor të vitit 2021 një rekomandim drejtuar autoriteteve shtetërore përgjegjëse të ngarkuara me ligj, ku ndër të tjera ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me kapacitetet akomoduese të strukturës së re në I EVP Lezhë, si dhe ka përsëritur nevojën për kompletimin me staf shëndetësor shtesë që do të duhet të kishte struktura e re, sipas standardeve dhe protokolleve shëndetësore për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor⁹.

Pavarësisht rekomandimeve të Avokatit të Popullit, në vizitën inspektuese në I EVP Lezhë vetëm 3 muaj nga transferimi i tyre nga I EVP Krujë, u evidentua se situata ishte mjaft problematike. Në konstatimin tonë struktura aktuale shëndetësore, por dhe stafi ndihmës (sanitarë dhe kujdestarë) e I EVP Lezhë nuk i përmbushin kërkesat për ofrimin e këtij shërbimi ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor. Kapacitetet janë shumë të vogla në përbërje për të përballuar numrin e personave të akomoduar në këtë I EVP si dhe personat e transferuar rishtaz në këtë institucion, por edhe për trajtimin e tyre në bazë të protokollit shëndetësor.

Siç e evidentuam edhe më lart institucioni ynë e vlerëson pozitiv Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë për transferimin e shtetasve me masë mjekësore nga I EVP Zahari, në ambientet e reja të krijuara në I EVP Lezhë. Marrëveshja e lidhur ndërmjet MD dhe MSHMS, shoqërohet dhe me një Plan të Përbashkët Veprimi ku përcaktohen disa nga hapat deri në ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor.

Por, ajo që ne kemi konstatuar në vizitën inspektuese, është se ende dhe sot nuk është përditësuar rregullore e funksionimit të Institucionit Tranzitor Lezhë (sipas planit të veprimit duhet të ishte realizuar në muajin Dhjetor 2021), por dhe ambientet e reja në I EVP Lezhë, konkretisht godinat 4 dhe 5, ende **nuk** ishin të pajisura me të gjithë infrastrukturën dhe bazën materiale të nevojshme dhe të domosdoshme mjekësore, personelin e specializuar mjekësor multidisiplinar, si dhe stafin psiko-social për trajtimin e këtyre personave.

⁹ Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Drejtësisë me shkresë nr.6667/1 prot., datë 17.01.2022 drejtuar Avokatit të Popullit, ka shprehur dakortësinë për çështjet e ngritura nga AP dhe thekson se: “Pomerrren masa në bashkëpunim me MSHMS, në përputhje me detyrimet e marrëveshjes së bashkëpunimit rregjistruar pranë MD me nr.6111 prot., datë 23.11.2021 dhe regjistruar pranë MSHMS me nr.4787 prot., datë 23.11.2021 “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore”.

Sikurse parashikohet dhe në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, menaxhimi i këtij spitali duhet të kalonte tërësisht nën administrimin dhe kujdesin e MSHMS, për të ofruar ndihmën dhe trajtimin e specializuar përkatës. Kjo masë e marrë aktualisht, mbetet shumë larg plotësimit të këtij detyrimi ligjor.

Nga vizita inspektuese e datës 17 shkurt 2022, u konstatua se, në të dy godinat ishin akomoduar në total **349 persona me masë mjekësore**, nga 184 persona që është kapaciteti fizik i tyre, **në kushtet e një situatë mbipopullimi me 165 persona mbi kapacitetin e numrit të përgjithshëm për mbajtjen dhe trajtimin mjekësor të tyre.** Në secilën nga dhomat ndodheshin gati 2 herë më shumë persona sesa kapaciteti, duke i bërë kushtet të papërshtatshme për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre. Pavarësisht mbipopullimit, personat e akomoduar ishin të pajisur të gjithë me krevat dhe asnjëri prej tyre nuk flinte me dyshekë në tokë.

Duke qenë se, situata e mbipopullimit në këtë institucion është e evidente, për arsye të menaxhimit të kushteve në të cilat ndodhen për shkak të mbipopullimit, drejtuesit e I EVP Lezhë ishin detyruar të shtonin numrin e shtretërve dhe personave në dhoma nga 2 në 4 deri dhe 7 persona, madje duke përshtatur në dhoma banimi edhe ambientet të cilat ishin të parashikuara për punën e stafit të administratës dhe stafin ndihmës dhe mbështetës.

Avokati i Popullit, në raportet vjetore drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, sidomos të këtyre 4 viteve të fundit, në lidhje me trajtimin e personave me masë mjekësore, ka sygjerruar rritjen e kapaciteteve akomoduese të institucioneve të sistemit penitenciar në përballimin e numrit gjithnjë e në rritje të vendimit të gjykatave në dhënien e masave mjekësore për personat me çrregullime të shëndetit mendor. AP ka evidentuar si problematikë dhe mungesën e bashkëpunimit ndërmjet organeve të prokurorive pranë gjykatave të rrethit gjyqësor dhe atyre të apelit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për zbatimin në mënyrë korrekte të ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale në RSH. Konkretisht, për zbatimin në mënyrë të ligjshme të vendimeve të gjykatës lidhur me masën mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik”, për shkëmbimin në kohë të informacionit mes tyre mbi kapacitetet mbajtëse të I EVP-ve, të cilat janë të klasifikuara për akomodimin e këtyre personave me masë mjekësore.

Përveç problematikave me infrastrukturën, trajtimin dhe mungesës së kushteve rekreative për këta persona me masë mjekësore (për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit do të hartojë një raport me rekomandime më vehte), u evidentua gjithashtu se, në **I EVP Lezhë ende nuk kishte një structure/organike unike të miratuar**, për të administruar dhe trajtuar në kushte të përshtatshme të paraburgosurit dhe njëkohësisht shtetasit me masë mjekësore. Stafi mjekësor dhe ai i sigurisë ishin ende në përbërje të I EVP Zahari, Krujë dhe nuk i përgjigjej numrit të personave të akomoduar në I EVP Lezhë. Ata kryenin detyra si të komanduar sipas funksioneve me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, deri në miratimin e strukturës së re organike për këtë institucion.

Situata e kompletimit me stafin shëndetësor, stafin mbështetës dhe psiko-social, edhe pas transferimit në ambientet e reja në I EVP Lezhë, paraqitet me mangësi krahasuar me numrin

në rritje të personave me çrregullime të shëndetit mendor, që akomodohen në institucionet e sistemit penitenciar. Aktualisht gjendja e kompletimit me **personel shëndetësor me kohë të plotë**, është si më poshtë:

- 6 mjekë: 2 mjek psikiatër, 1 mjek kardiolog, 1 mjek i përgjithshëm, 1 stomatolog dhe 1 farmacist;
- 11 personel i mesëm mjekësor: 1 kryeinfermier dhe 10 infermierë;
- 10 personel mbështetës: 5 kujdestarë dhe 5 sanitarë;
- 8 punonjës të sektorit psiko-social: 6 punonjës social dhe 2 psikolog.

Mungesa e kapaciteteve fizike, pra ndërtimi i institucionit të posaçëm mjekësor, ardhur kjo për shkak të mungesës së burimeve financiare të mjaftueshme, për ta përballuar këtë situatë, hyn tek detyrimet që kanë karakter material. Në gjykimin tonë nga ana e shtetit duhen marrë masa të menjëherëshme për zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike, bazuar dhe në angazhimet që Qeveria Shqiptare ka bërë pranë KPT-së dhe GJEDNJ-së.

Ndërsa, mungesa e vullnetit të kapaciteteve administrative në plotësimin dhe shtimin e kapaciteteve të stafit shëndetësor për trajtimin mjekësor të këtyre personave, nuk është e justifikueshme, dhe në këtë rast kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit në fuqi.

Sikurse e referuam edhe më lart, ndër vite kjo kategori personash ka vuajtur dhe jetuar në kushte jo dinjitoze dhe në kundërshtim me aktet kombëtare dhe ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është edhe ndëshkuar për këtë problematikë. Konkretisht, në datë 21 janar 2020, Shqipëria humbi gjyqin në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në rastin “*Strazimiri kundër Shqipërisë*”¹⁰. GJEDNJ konstatoi në veçanti që kishte pasur një dështim të gjatë nga autoritetet shqiptare **për të ngritur një institucion të posaçëm mjekësor për të sëmurët mendor**, të cilët ishin privuar nga liria në rastet e trajtimit të detyrueshëm mjekësor të urdhëruar nga gjykata vendase.

Në të gjitha raportet, që janë hartuar apo rekomandimet që janë adresuar në këtë fushë, është evidentuar fakti se sa i rëndësishëm është krijimi i një Institucioni të Posaçëm Mjekësor në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar, me qëllim trajtimin mjekësor dhe psikiatrik që e ka të domosdoshëm kjo kategori e personave me masë mjekësore. Ofrimi i një infrastrukture me kushte të tilla, do të japë mundësinë e një jete me dinjitet e në respekt të të drejtave të njeriut.

¹⁰ Ky rast kishte të bënte me ndalimin e një njeriu, i cili ishte përjashtuar nga përgjegjësia penale për shkak të sëmundjes mendore, në një burg në vend të një institucioni mjekësor. Parashtruesi ankohej në veçanti se kushtet e ndalimit të tij, përfshirë sigurimin e kujdesit mjekësor, ishin joadekuate. Ai po ashtu konsideronte se ishte vendosur në një burg edhe pse gjykatat kishin urdhëruar mbylljen e tij në një institucion mjekësor, se nuk i ishte dhënë mundësia që ligjshmëria e ndalimit të tij të vendosej shpejt nga një gjykatë dhe se ligji i brendshëm nuk i kishte ofruar një të drejtë të zbatueshme për kompensim.

Në Rregullat Europiane të burgut¹¹ miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 12 shkurt 1987¹² vendosen parimet e përbashkëta të politikës penale midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Komiteti i Ministrave rekomandon qeveritë e shteteve anëtare që në legjislacionin dhe praktikën e tyre të brendshme në fushën e burgjeve, të udhëhiqen nga parimet e “Rregullave Europiane të Burgut”. Megjithëse këto rregulla nuk kanë karakter detyrues ligjor në të drejtën ndërkombëtare, ato përbëjnë një kod të standarteve dhe të praktikës që bazohen në konsensusin e përgjithshëm të të gjithë atyre vendeve që i kanë miratuar rregullat nga pikëpamja politike ose në planin ligjor.

Në këtë aspekt, mbyllja e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në institucione të veçanta brenda sistemit penitenciar, përbën dhunim të rëndë të të drejtave të tyre, pasi në një farë mënyre i vendos ata në një formë të përjetshme të privimit të lirisë¹³. Kjo pasi, gjendja e papërgjegjshmërisë mendore tek të sëmurët mendorë kronikë mund të zgjasë gjatë gjithë jetës së tyre, dhe si rrjedhim, edhe izolimi në institucione të veçanta do të ishte i përjetshëm.

Një zgjidhje e përshtatshme për ofrimin e shërbimit të nevojshëm shëndetësor ndaj këtyre personave do të ishte ngritja e qendrave të trajtimit psikiatrik ligjor (Forensic Psychiatric Centers), si struktura në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Këto qendra do të funksiononin si njësi të veçanta për ofrimin e programeve gjithëpërfshirëse të vlerësimit, trajtimit dhe rehabilitimit të të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor. Për të siguruar një trajtim sa më kompetent dhe sa më afër nevojave të të sëmurëve mendorë programet e ofruara në këto qendra duhet të fokusohen në dy linja kryesore veprimi:

- a) ofrimi i ndihmës së specializuar mjekësore dhe klinike;
- b) ofrimi i trajtimeve me bazë komunitare që mundësojnë vendosjen e tyre të monitoruar në mjedise gjysmë të hapura.

Siç e evidentuam dhe më lart Avokati i Popullit e vlerëson si një hap pozitiv nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor.

Gjitashtu, evidentojmë se, në këtë marrëveshje shprehet angazhimi dypalësh nëpërmjet marrjes së masave për adresimin e rekomandimeve të mekanizmave monitorues ndërkombëtarë dhe kombëtarë, si dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në këtë fushë.

¹¹ Referuar Rekomandimit 2006 (2) i Këshillit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Europiane të Burgjeve, miratuar nga Këshilli i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të Zëvendësministrave. Ky dokument është shpërndarë në të gjitha burgjet shqiptare më datën 13.04.2012.

¹² Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës që nga viti 1995.

¹³ Albrecht, H.J. Plenary speech – Punimet e Konferencës së dytë vjetore të Max Planck Partner Group on Balkan Criminology, ‘Imprisonment in the Balkans’, 17-19 shtator 2015, Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë.

Në Planin e Përbashkët të Veprimit, është i rëndësishëm fakti që IEVP Lezhë konsiderohet “institucion tranzitor”, deri në konkretizimin e hapave për ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor.

Por, referuar planit të veprimit të përbashkët, pamvarësisht se parashikohet kryerja e vlerësimeve për çdo pacient, rezulton se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka rritur praninë e stafit mjekësor në IEVP Lezhë.

Në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030 (ende në proces miratimi pas konsultimit publik), MSHMS nuk ka përcaktuar masa konkrete për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor për të cilët gjykata kompetente ka dhënë masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i detyruar”. Gjithashtu nuk gjendet asnjë akt për plotësimin e detyrimit ligjor për ndërtimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm, mbi bazën e të cilit do të duhet të planifikohen fonde për mbështetje buxhetore në vitet pasardhëse, apo dhe në buxhetin afatmesëm të kësaj ministrie.

Në këto kushte, kur në IEVP Lezhë është evidente situata e mbipopullimit dhe mungesa e miratimit të strukturës organike, kërkohet që autoritetet përgjegjëse shtetërore si Ministria e Drejtësisë, MSHMS dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të kryejnë menjëherë një studim bazuar në numrin e personave që janë me masë mjekësore në sistemin e burgjeve, për nevojën e rritjes të numrit të stafit mjekësor, si dhe shtimin e kapaciteteve fizike të këtij institucioni, me qëllim mbajtjen dhe trajtimin e këtyre personave, sipas protokolleve shëndetësore.

Të nderuar,

Avokati i Popullit, sa më lart tërheq vëmendjen e autoriteteve shtetërore për mungesën e hartimit të këtij studimi, i cili duhet të ishte përfunduar para se të kryhej transferimi i këtyre personave nga IEVP “Zahari”, Krujë në IEVP Lezhë. Ky studim, duhet të fokusohet në rritjen e kapaciteteve mbajtëse për pesonat me masë mjekësore dhe njëkohësisht duhet të evidentojë nevojën për shtimin e stafeve mjekësore dhe atyre mbështetëse për këtë kategori, pasi kapaciteti fizik i dy godinave të reja dhe stafi aktual mjekësor i transferuar nga IEVP Zahari, Krujë, janë të pamjaftueshme për të akomoduar dhe trajtuar personat me masë mjekësore, sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare, për këtë qëllim.

Referuar eksperiencës të vendeve të rajonit, konkretisht Republikës së Kosovës, nga gushti i vitit 2014 ky shtet ka ngritur Institutin e Psikiatrisë Forenzike, i cili është nën menaxhimin e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, me kapacitet prej 36 shtretër. Në këtë institut akomodohen personat të cilët kanë kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore dhe janë subjekt i urdhërit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, apo edhe për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucion shëndetësor.

Në raport me numrin e personave të akomoduar në këtë institut, personeli shëndetësor përbëhet nga 26 mjek/infermier/punonjës social (specialiteti psikiatër të përgjithshëm,

psikiatër forenzik, punëtor social, psikolog, etj.), si dhe 17 punonjës të stafit administrativ dhe atij ndihmës, që shkon në 43 të punësuar.

Sa më sipër, evidentohet se për një numër të ulët shtretërisht, personeli shëndetësor e social, si dhe ai ndihmës, që kryejnë shërbimin dhe kujdesin shëndetësor ndaj këtyre personave me masë mjekësore, është afërsisht në raportin 1 personel shëndetësor/1 pacient.

Eksperinca e Kosovës është një shembull shumë i mirë, më i miri në rajon, pasi në këtë shtet megjithëse ligji për shëndetin mendor hyri në fuqi në nëntor 2015, Instituti i Psikiatrisë Forenzike (IPFK) ishte efektiv që në 2014, me mbështetjen e zyrës së OBSH me seli në Prishtinë.

Ndërsa Shqipëria ende nuk e ka një Institucion të posacëm mjekësor, gjendemi para faktit se në I EVP Lezhë, janë akomoduar 349 persona me masë mjekësore dhe me një mbipopullim 165 persona mbi kapacitetin e godinave. Ky institucion ka në organikë një numër modest personeli shëndetësor, i cili nuk është në gjendje të përballojë as fluksin aktual as atë në rritje të personave të shtruar me masë mjekësore.

Si përfundim, nga sa parashtruam edhe më lart, bazuar në takimet e zhvilluara nga institucioni i Avokatit të Popullit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe intervistat e zhvilluara me drejtuesit dhe stafin mjekësor në I EVP Lezhë, ritheksojmë se është e nevojshme dhe e domosdoshme shtimi i personelit shëndetësor i përbërë me mjek të përgjithshëm, mjek psikiatër, mjek kardiolog, mjek laborant klinik biokimik, infermierë, sanitarë dhe kujdestarë për pacientë me masë mjekësore, si më poshtë vijon:

- a) *Sektori shëndetësor në seksionin e masave shëndetësore nga 18 personel shëndetësor aktual, të bëhet me 36 mjekë dhe infermierë.*
- b) *Sanitarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 sanitarë.*
- c) *Kujdestarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 kujdestarë.*

Kjo shtesë organike, do të ishte modeste, por do të ndihmonte sado pak në përmirësimin dhe përballimin e vështirësive të ofrimit të shërbimit shëndetësor e social, që ndër vite nuk po gjejnë zgjidhje për këtë kategori personash. Do duhej që, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si pjesë e planit të veprimit, mund të konsiderojë kërkesën për shtesa në buxhet, për këtë kategori, që krahas pagës bazë, t'u ofrojë edhe bonuse personelit shëndetësor apo psiko-social, që punojnë në burgje, për shkak të punës specifike që ata kanë me të burgosurit.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;

REKOMANDOJMË:

1. Deri në ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor, **të merren masa të menjëhershme**, për hartimin/miratimin e rregullores së funksionimit të Institucionit Tranzitor Lezhë.
2. Të merren masa të menjëhershme, për miratimin sa më parë të strukturës organike të IEVP Lezhë, bazuar në një studim të qartë dhe konkret të kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë¹⁴, për të shtuar kapacitetet e shërbimit mjekësor dhe shërbimeve mbështetëse të këtij institucioni, me qëllim rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj personave me masë mjekësore.
3. Të merren masa të menjëhershme, në kuadër të investimeve të Qeverisë Shqiptare për Rindërtimin, të cilat janë planifikuar për t'u kryer për rikonstruksionin e godinave të tjera në territorin e IEVP Lezhë, të ndërtohet dhe përshtatet dhe njëra prej godinave, për shkak të rritjes së numrit të personave me masë mjekësore me çrregullime të shëndetit mendor, që ndodhen në institucionet e sistemit peniteciar.
4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në Planin e Përbashkët të Veprimit për trajtimin e personave me masë mjekësore, të detajojnë aktivitete specifike me afate kohore konkrete për këta persona, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA

¹⁴ Referuar dhe ankesit të marrëveshjes lidhur me Planin e përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore